



Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete
Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik

Shqetësimet lidhur me Konfirmim të Aktakuzës

Edicioni 8

Tetor 2010

Përmbledhje Ekzekutive

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSBE), është e brengosur që sistemi i drejtësisë penale mund të shkel ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe kornizën ligjore të Kosovës, kur gjykojnë konfirmimin e aktakuzës gjatë procedurave gjyqësore penale. OSBE ka vërejtur një numër seancash të konfirmimit të cilat nuk kanë qenë në pajtim me kornizën ligjore të Kosovës dhe shkelën të drejtën e të pandehurit për gjykim korrekt.

OSBE ka monitoruar seanca të konfirmimit ku ka pasur më pak se shpalosje të plotë të materialeve nga ana e prokurorisë për mbrojtjen, mbajtje jo të saktë të procesverbalit, kushtet për gjykim publik të cilat nuk janë përmbushur, dhe vendime për konfirmim me pak apo aspak arsytim. Nga kjo që u tha, jo të gjitha vrojtimit e OSBE-së ishin negative, dhe raporti përfundon me një shembull të një seance të konfirmimit që ishte arsyetuar mirë.

Dështimi për t'ia Shpalosur të Pandehurve Materialet

Ligji ndërkombëtar parasheh që prokuroria dhe mbrojtja të trajtohen në mënyrë të barabartë, përfshirë këtu që të kenë edhe mundësi të barabarta për ta prezantuar rastin e tyre. Njëra palë nuk duhet të vendoset në pozitë përmbajtësisht të pafavorshme në krahasim me tjetrën. Ky kusht përfshin nevojën që prokuroria t'ia transferojë mbrojtjes materialin me të cilin ai disponon.¹ Korniza ligjore në Kosovë është në përputhje me ligjin ndërkombëtar.

Kodi i aplikuar Procedurës Penale i Kosovës² (KPPK) rregullon procedurat për aktakuzat dhe konfirmimin e aktakuzave. Termi aktakuzë nuk është i definuar, mirëpo KPPK sqaron, mes pikave tjera, se aktakuza duhet të përmbajë “[k]ohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale”³ dhe “[sh]pjegimin e arsyeve për ngritjen e aktakuzës... dhe provat që vërtetojnë faktet kryesore.”⁴ KPPK definon seancën e konfirmimit si “është seancë ku gjyqtari merr aktvendim mbi aktakuzën...”⁵

Prokurori duhet t'ia ofrojë avokatit mbrojtës materialin në të cilin e mbështet aktakuzën jo më vonë se në kohën e ngritjes së aktakuzës, nëse kjo nuk i është ofruar më herët.⁶ Pas ngritjes së aktakuzës ka obligim të vazhdueshëm për prokurorinë që brenda 10 ditëve nga pranimi, t'i sigurojë mbrojtjes çfarëdo materiali të ri që ka në posedim.⁷ OSBE është e brengosur që ky material nuk i ofrohet çdoherë të pandehurit.

¹ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Foucher kundër Francës*, 18 mars 1997, paragrafi 36.

² Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2003/26, 6 korrik 2003, me ndryshimet pasuese. Me 22 dhjetor 2008, Kosova ka shpallur Ligjin Nr. 03/L-003 mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës Nr 2003/26, që la ligjin përmbajtësisht të njëjtë me ligjin e vitit 2003, edhe pse ishte shtuar një pjesë për aranzhimet lidhur me deklarimin e fajësisë, një nen mbi kohëzgjatjen e paraburgimit policor ishte ndryshuar dhe emri i ligjit ishte ndryshuar në Kodi i Procedurës Penale i Kosovës.

³ KPPK Neni 305 paragrafi 1 (4).

⁴ KPPK Neni 305 paragrafi 1 (5).

⁵ KPPK Neni 151(12).

⁶ KPPK Neni 307(1).

⁷ KPPK Neni 307(3).

Me 23 nëntor 2009, në një gjykatë të qarkut disa avokatë mbrojtës informuan gjyqtarin për konfirmim se prokurori kishte dështuar t'iu siguroi mjetet të cilat ishin material për përgatitje të mbrojtjes. Materiali përfshinte video-incizime, dhe telefonike të cilat prokuroria planifikonte t'i përdorte kundër të pandehurve. Avokatët mbrojtës kundërshtuan mos-ofrimin e mundësisë që të marrin dhe shqyrtojnë video-incizimet dhe ato telefonike para gjykimit, dhe kërkuan të drejtën për të inspektuar materialin që posedonte prokuroria dhe gjykata. Gjyqtari për konfirmim u përgjigj se materiali do të ekzaminohet gjatë shqyrtimit kryesor. Kërkesa e avokatëve mbrojtës për këto materiale ishte mohuar.

Seanca për konfirmim të aktakuzës i lejon të pandehurit të drejtën për të kundërshtuar pranueshmërinë e dëshmive.⁸ Por kjo nuk është e drejtë reale nëse mbrojtjes nuk i jepet e drejta për të shqyrtuar materialin apo për të sfiduar në mënyrë efektive atë që është në posedim të prokurorit. Mohimi i qasjes së mbrojtjes në video-incizimet dhe ato telefonike të cilat pandehnin fajësinë, dhe të cilat prokuroria planifikonte t'i përdor kundër të pandehurve në gjykim, shkelën të drejtat e të pandehurve në së paku tri fusha.

Së pari, gjykata shkeli parimin fundamental të paraparë në Nenin 10 paragrafin 1 të KPPK-së: “Nëse me këtë Kod nuk parashihet ndryshe, i pandehuri dhe [prokurori] në procedurë penale kanë pozitë të barabartë.”

Së dyti, mohimi i qasjes në këto materiale shkeli Nenin 142 (2) të KPPK-së për të drejtën për shikimin e shkresave: “Pas përfundimit të hetimit, mbrojtësi ka të drejtë të shikojë, të kopjojë ose t'i fotografojë të gjitha shkresat dhe provat materiale me të cilat disponon gjykata.”

Së treti, duke i mohuar mbrojtjes qasje në video-incizime dhe ato telefonike për seancën e konfirmimit shkel Nenin 142(3) të KPPK-së: “[M]brojtësi...lejohej...të shikojë, të kopjojë ...objekte të tjera materiale... në kontroll të prokurorit publik, materiale të cilat shërbejnë për përgatitjen e mbrojtjes[...].”⁹

Procesverbalet jo-adekuate gjyqësore

Përpos vëzhgimit të situatave kur avokatët mbrojtës nuk trajtohen barabartë me prokurorët, OSBE ka vërejtur situata kur procesverbali i gjykatës nuk ka reflektuar atë çfarë ka ndodhur, kur të drejtat e të pandehurit ishin mohuar.

Me 16 gusht, procesverbali i gjykatës për një seancë konfirmimi, pasqyronte se i pandehuri ishte informuar për të drejtat e tij. Këto të drejta përfshijë të drejtën për mos t'iu përgjigjur pyetjeve të caktuara, të mos jap deklaratë që mund të inkriminojë veten ose të afërmit, të drejtën për t'u mbrojtur vet apo përmes avokatit mbrojtës dhe për të kundërshtuar aktakuzën ose pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.¹⁰ OSBE megjithatë ka vërejtur se i pandehuri nuk ishte informuar lidhur me asnjërën nga të drejtat e lartpërmendura. Çfarë

⁸ KPPK Neni 311.

⁹ KPPK Neni 142(3).

¹⁰ KPPK Neni 314.

thuhej në procesverbal nuk ishte e saktë. I pandehuri nuk ishte informuar lidhur me të drejtat e tij.

Në rastin e mësipërm, në seancën e konfirmimit gjykata futi të dhënat në procesverbal në formë shablloni për atë çfarë i pandehuri duhet të informohet në vend së të krijojë një dokument për të treguar se çka në të vërtetë ka ndodhur.

Kushtet jo të Përmbushura për Gjykim Publik

Mbajtja publike e seancave gjyqësore përbën parim fundamental të se drejtës për gjykim korrekt, duke e mbajtur sistemin e drejtësisë të hapur për vështrim publik dhe duke i mbrojtur palët nga ushtrimi arbitrar i pushtetit shtetëror. OSBE ka raportuar më parë lidhur me këtë temë,¹¹ megjithatë deri më tani nuk është vërejtur ndonjë përmirësim i konsiderueshëm.

E drejta për gjykim publik është e garantuar me ligj ndërkombëtar.¹² Si pjesë e obligimit për të siguruar mbajtjen publike të seancës, autoritetet duhet të sigurojnë që informacioni lidhur me datën dhe vendin e dëgjimit të jetë gatshëm e qasshme për publikun.¹³

Korniza ligjore në Kosovë përmban këtë kusht. Parasheh që shqyrtimi kryesor do të jetë publik¹⁴ dhe përjashtimi i publikut është i lejuar vetëm nën disa rrethana të kufizuara.¹⁵ Seanca për konfirmim duhet të jetë në përputhje me kushtet e njëjta si ato për shqyrtim kryesor, përfshirë këtu edhe kushtin që ajo të jetë publike.¹⁶

Për më tepër, OSBE shpesh ka gjetur se mënyra e vetme për të marr informatën lidhur me kohën dhe vendin e seancës së konfirmimit është që personalisht të bisedohet me gjyqtarin i cili drejton seancën. Informata lidhur me, dhe qasja në gjykim mund eventualisht t'i jepet anëtarëve të veçantë të publikut që kanë njohuri të sistemit, mirëpo përpjekja e madhe përbën pengesë për të vëzhguar gjykimin. Kjo ndikon negativisht në të drejtën e të akuzuarit dhe të tjerëve për gjykim publik.

Arsyetimi jo i duhur dhe i Pamjaftueshëm në Vendimet për Konfirmim të Aktakuzës

OSBE ka vërejtur mangësi në arsyetim të vendimeve për konfirmim të aktakuzës. Mungesa e arsytimit shkel ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe KPPK-në.

Standardet ndërkombëtare dhe praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kërkojnë nga gjykatat që ato të ofrojnë arsye për vendimet dhe aktgjykimet e

¹¹ Shih, Raportin e Seksionit për Monitorim e Sistemit Juridik (SMSJ), Reforma dhe Shqetësimet e Mbetura 31 mars 2006, fq. 50-51, e qasshme në : http://intranet/n/s/documents/monitoring/4/405_2.pdf.

¹² Neni 6(1) Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Neni 14(1) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike NDCP; Neni 10 Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut.

¹³ *G.A van Meurs kundër Holandës*, Komunikata Nr. 215/1986, U.N. Doc. CCPR/C/39/D/215/1986 (1990), e qasshme në : <http://www1.umn.edu/humanrts/undocs/session39/215-1986.html>.

¹⁴ KPPK Nenet 328-331.

¹⁵ KPPK Neni 329.

¹⁶ KPPK Neni 313(3).

veta.¹⁷ Ngjashëm, KPPK parasheh që “[t]ë gjitha aktvendimet e marra nga gjyqtari lidhur me konfirmimin e aktakuzës duhet të arsyetohen...”.¹⁸ Ngjashëm me nevojën për procesverbal të saktë të procedurave gjyqësore, vendimi i arsyetuar, mes tjerash, demonstroi që palët janë dëgjuar, lejon vështrim të sistemit të drejtësisë nga ana e publikut, dhe është i domosdoshëm për të lejuar ankesën. Dështimi i gjykatave për të sqaruar arsyen për konfirmimin apo refuzimin e aktakuzës shkel ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

OSBE ka monitoruar një numër rastesh që nuk ishin mjaftueshëm të arsyetuara dhe më parë ka raportuar mbi këtë temë.¹⁹ Përderisa ka përjashtime, shumica e vendimeve vazhdojnë të jenë dobët të arsyetuara.

Jo të gjitha Vendimet për Konfirmim janë Dobët të Arsyetuara

Edhe pse shumë vendimeve për konfirmim të aktakuzës u mungon arsyetimi i mjaftueshëm, ky raport i OSBE-së ka dëshirë të nënvizojë një vendim për konfirmim të arsyetuar mirë, i cili mund të shërbejë si model për të tjerët.

Me 27 korrik 2010, në një gjykatë të qarkut vendimi për seancën e konfirmimit në një rast ku përfshiheshin tre të pandehur ishte arsyetuar mirë. Duke zbatuar Kodin Penal të Kosovës²⁰ (KPK), tre të pandehurit ishin akuzuar për furnizim, transport, prodhim, këmbim apo shitje të paautorizuar të armëve.²¹ Dy nga tre të pandehurit ishin akuzuar për mbajtje në pronësi, kontroll, posedim apo përdorim të paautorizuar të armëve.²² Dy të pandehur të tjerë ishin akuzuar për krim të organizuar.²³ Akuzat për armëmbajtje ilegale ishin konfirmuar, ndërsa akuzat për veprimtari në krim të organizuar ishin refuzuar.

Para se të sqarojë arsyet lidhur me mënyrën se si gjykata ka marr vendimin, vendimi për konfirmim së pari kishte vërtetuar se aktakuza ishte ngritur në pajtim me Nenet 304-309 të KPPK-së. Gjyqtari për konfirmim më pas vërtetoi se të pandehurit kishin kuptuar aktakuzën, kishte dëgjuar deklaratimet e tyre që pandehnin pafajësinë dhe më pas dëgjoi kundërshtimet e ngritura nga avokatët mbrojtës.

Ky vendim ishte veçanërisht mirë i arsyetuar në sqarimin e gjykatës sa i përket refuzimit të pikave të aktakuzës që kishin të bënin me krim të organizuar. Gjyqtari për

¹⁷ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Ruiz Torija kundër Spanjës*, 9 dhjetor 1994, paragrafi 29; Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Hirvisaari kundër Finlandës*, 27 shtator 2001, paragrafi 30.

¹⁸ KPPK Neni 317(1).

¹⁹ Shih, Raportet e Seksionit për Monitorim e Sistemit Juridik (SMSJ) mbi Sistemin e Drejtësisë Penale në Kosovë, 31 mars 2006, fq. 24-25, e qasshme në : http://www.osce.org/documents/mik/2006/12/22703_sq.pdf; dhe 31 tetor 2004, fq. 17-19, e qasshme në: http://www.osce.org/documents/mik/2004/12/3984_sq.pdf.

²⁰ Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2003/25, 6 korrik 2003, me ndryshimet pasuese. Me 6 nëntor 2008, Kosova ka shpallur Ligjin Nr. 03/L-002 mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës Nr 2003/25, që la ligjin përmbajtësish të njëjtë me ligjin e vitit 2003, me vetëm një pjesë të shtuar për aranzhimet lidhur me deklaratimet për fajësi dhe ndryshimin e emrit të ligjit në Kodi Penal i Kosovës.

²¹ KPK Neni 327.

²² KPK Neni 328.

²³ KPK Neni 274.

konfirmim dëgjoi kundërshtimet e mbrojtësve që përfaqësonin dy të pandehurit të ngarkuar me krim të organizuar, shqyrtoi KPK-në dhe më pas ju kthye ligjit ndërkombëtar për udhëzime shtesë. Vendimi trajtonte definicionet nga KPK, përfshirë termet “krim i organizuar”²⁴ dhe “grup i strukturuar.”²⁵

Vendimi në arsyetimin e vet kishte futur edhe ligjin ndërkombëtar duke nënvizuar se Neni 2(a) i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional,²⁶ e cila definon termin “grup i organizuar kriminal,” që po ashtu parasheh një numër pre minimum tre personash që veprojnë në bashkëpunim është formuar me qëllim të kryerjes së veprës së rëndë para një grupi të strukturuar, që do të mund ta vendoste dikë para akuzës për krim të organizuar.

Në përmbledhje, ndërsa OSBE ka nënvizuar vendimin e lartë-përmendur për konfirmim të jetë mirë i arsyetuar, ky rast po ashtu është vërejtur si një përjashtim për shumicën e rasteve të monitoruara.

Rekomandime

Për Gjykatat

- Seancat për konfirmim duhet të jenë në pajtim me kushtet për gjykim publik të parapara me KPPK, dhe kjo përfshin shpalljen e kohës dhe vendit së seancës.
- Të sigurojë që informatat të jenë të sakta kur t’i kompletojnë procesverbalet gjyqësore.
- Vendimet për konfirmim të aktakuzës duhet të kenë arsyetim të mjaftueshëm.
- Gjykatat duhet të ndihmojnë në bartjen tek mbrojtja të tërë materialit relevant që është në posedim të prokurorisë apo të gjykatës.

Për Prokurorët

- Prokurorët duhet t’ia bartin mbrojtjes të gjithë materialin relevant.

Për Institutin Gjyqësor të Kosovës

- Të trajnojë gjyqtarët dhe prokurorët për kushtin e bartjes së dëshmive tek mbrojtja, përpilimin e procesverbaleve të sakta, mbajtjen publike të gjykimeve dhe përpilimin e arsyetuar të vendimeve për konfirmim.

²⁴ KPK Neni 274(7)(1). Termi ‘krim i organizuar’ do të thotë krim i rëndë i kryer nga ndonjë grup i strukturuar.

²⁵ KPK Neni 274(7)(4). Termi ‘grup i strukturuar’ do të thotë grup prej tre ose më shumë personave i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e atypëratyshme të ndonjë vepre penale.

²⁶ Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional, Rezoluta e Këshillit të Përgjithshëm të KB-ve 55/25, 15 nëntor 2000, hyri në fuqi me 29 shtator 2003.